



## PROCESVERBAL

Mbledhja e rregullt e komitetit për politikë dhe financa, e mbajtur më 19.08.2022, me fillim në ora 10:00. Mbledhjen e kryesoi kryesuesi i kuvendit **Defrim Kafexhiu**.

**Kryesuesi –** Fillimisht më lejoni të ju përshëndes të gjithëve, nënkyetarin **Fatmir Iska**, të nderuar anëtarë të komitetit për politikë dhe financa, drejtore të drejtive, media dhe të gjithë ju të pranishëm. Faleminderit shume për pjesëmarrjen, e hapim mbledhjen e 7-të të komitetit për politikë dhe financa.

Të nderuar anëtare të KPF-së, bashkë me kryetarin kemi përpiluar këtë rendi dite me gjithsej 10 pikë;

## REND DITE

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Shqyrtimi i Planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve nga Raporti i Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit për vitin 2021;
3. Shqyrtimi i propozim vendimit për formimin e komisionit për emërtimin dhe riemërtimin e rrugëve, rrugicave, parqeve, shesheve dhe lagjeve në komunën e Rahovecit;
4. Shqyrtimi i propozim vendimit për shpallje me interes të përgjithshëm publik pjesën e P-71510057-0234-2 në zonën kadastrale Rahovec;
5. Shqyrtimi i propozim vendimit për dhënen e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim personave fizik dhe juridik P-71510057-05864-0 zona, në kadastrale Rahovec;
6. Shqyrtimi propozim vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale P-71510057-05864-0 zona, në kadastrale Rahovec;
7. Shqyrtimi i propozim vendimit për dhënen e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim personave fizik dhe juridik P-71510021-00010-1 dhe P-71510021-00010-2, në zona kadastrale Dobidol;
8. Shqyrtimi propozim vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale P-71510021-00010-1 dhe P-71510021-00010-2, në zona kadastrale Dobidol;
9. Shqyrtimi i propozim vendimit për shfuqizimin e vendimit 01 Nr.337/22, i datës: 29.06.2022 për dhënen në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës;
10. Të ndryshme.

**Kryesuesi** – Dikush ndonjë koment lidhur me këtë rendi dite?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim, kush është për aprovim?... Me shumicë të votave aprovohet rendi i ditës për sot. Vazhdojmë me pikën e parë të rendit të ditës;

**1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**

Dikush prej anëtarëve të komitetit ndonjë koment lidhur me procesverbalin?... E vendosim në votim, kush është për? ... Me shumicë votash aprovohet procesverbali nga mbledhja e kaluar.

**2. Shqyrtimi i planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve nga raporti i auditimit nga zyra kombëtare e auditimit për vitin 2021;**

**Afrim Limani** – Faleminderit kryesues, përshëndetje për ju dhe për anëtarët e KPF-së. Auditimi i pasqyrave financiare i komunës së Rahovecit si dokument është përfunduar dhe është diskutuar në seancën e kaluar, ku kam pasur shumë sulme nga ju sa i përket kësaj pike. Në auditim e keni vërejtur që ekzistojnë 14 rekomandime dhe sipas rregullave të ZKA-së e kemi formuar një komision prej 9 anëtarëve për zbatimin e këtyre rekomandimeve të zyrës kombëtare të auditorit. Takimin e parë e kemi mbajtur, ku kemi diskutuar dhe plotësuar një dokument që e keni ju përparrë vetes dhe shpresojmë që deri në fund të vittit pjesa më e madhe e rekomandimeve do të zbatohen. Te çdo e gjetur shkruan “pajtohem” dhe nëse nuk kemi dhënë koment aty nuk ka shkruar fare, sikur t’ a kishim ditur gjithësesi që i kishim dhënë komentet tona edhe pse prioritet ka qenë rekomandimi themelor që në bazë të atij rekomandimi janë klasifikuar edhe pasqyrat financiare. Këtë dokument-raport e kemi dërguar në ZKA dhe në çdo tre muaj duhet të mbajmë nga një takim. Sa për informatën tuaj, unë e kam bërë një analizë që prej saj besoj që rrëth 8 rekomandime do të zbatohen dhe 6 të tjera nëse jo plotësisht, pjesërisht do të zbatohen.

**Kryesuesi** – Faleminderit drejtor, a ka dikush prej anëtarëve të KPF-së diqka për të thënë?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim këtë pike të rendit të ditës, kush është për?... Me shumicë votash aprovohet pika e dytë e rendit të ditës.

**3. Shqyrtimi i propozim vendimit për formimin e komisionit për emërtimin dhe riemërtimin e rrugëve, rrugicave, parqeve, shesheve dhe lagjeve në komunën e Rahovecit;**

**Albnor Mullabazi** – Faleminderit kryesues, i nderuar nënkyetar, drejtorë, anëtarë të KPF-së. Në mbështejte të nenit 13 dhe 58 të ligjit për vetqeverisje lokale dhe ligjit për sistem të adresave, kemi propozim-vendimin e kryetarit të komunës për formimin e komisionit për emërtim, riemërtim të rrugëve, rrugicave, parqeve, shesheve dhe lagjeve urbane në komunën e Rahovecit. Komisioni do të përbahet prej 5 anëtarëve, 3 prej tyre nga kuvendi dhe dy nga ekzekutivi.

**Burim Krasniqi** – Vetëm një pyetje drejtor, a është shtjerrë konsultimi me ministrinë e mjedisit dhe planifikimit hapësinor që mos të kemi problem të rikthehet prapë si vendimi i kaluar.

**Albnor Mullabazi** – Po Burim, i kemi shikuar këto gjera. I njëjtë komision për ankesa herën e parë është pranuar vetëm kjo është kthyer.

**Kryesuesi** – Faleminderit drejtor, dikush tjetër?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim, kush është për?... Me shumicë votash aprovohet edhe pika e tretë e rendit të ditës, vazhdojmë me pikën e katërt; 4.

**4. Shqyrtimi i propozim vendimit për shpallje me interes të përgjithshëm publik pjesën e P-71510057-0234-2 në zonën kadastrale Rahovec;**

Në mungesë të drejtorit të kadastrës, e ftoj nënkyetarin për prezantimin e kësaj pike.

**Nënkyetari** – Faleminderit i nderuar kryesues, anëtarë të KPF-së, drejtorë dhe gjithë të pranishëm. Në mungesë të drejtorit për kadastër, po e prezantoj këtë pikë të rendit të ditës, është shpallja e vendimit me interes të përgjithshëm, praktikisht po ju tregoj se ku gjendet, te rr” Gëzim Hamza-piktori” ose më konkretisht nëse e dini afér shtëpisë së Xhelal Canzibës, përbollës është një autolarje – një rrugë e re që e kemi shtruar me kubëza që lidhet me rrugë fushore. Një pjesë ku kërkohet të lirohet rruga dhe pastaj bëhet hapja e rrugës së re meqenëse është pronë private dhe krijohet bllokadë për një sipërsaqe bukur të madhe të vreshtave. Ky është interes i kësaj. E di që para 3 viteve ka bërë kërkessë edhe Nysret Shehu nëse nuk gaboj, por në seancë të rregullt drejtori do t’ a njofton kuvendit për detaje.

Kryesuesi - Faleminderit nënkyetar, a ka dikush ndonjë koment?... Nëse jo, atëherë po e vendosim pikën e katërt, kush është për?... Me shumicë votash aprovohet pika e katërt e rendit të ditës, vazhdojmë me pikën e pestë;

**5. Shqyrtimi i propozim vendimit për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim personave fizik dhe juridik P- 71510057-05864-0 zona, në kadastrale Rahovec;**

**Berat Duraku** – Faleminderit kryesues, të nderuar anëtarë të KPF-së, i nderuar nënkyetar, kolegë drejtorë. Para jush keni materialin për dhënien në shfrytëzim të tokës bujqësore në zonën kadastrale në Rahovec P- 05864-0 me sipërfaqe totale prej 2031m katror (20 ari e 31m) arë e klasës së pestë në vendin e quajtur Përzhin, kjo parcelë sipas planit zhvillimor komunal është e destinuar si tokë bujqësore, qëllimi i dhënies në shfrytëzim është ruajtja dhe mbrojtja e pronës komunale - rritja e vlerës së saj. Propozimi është që kjo parcelë të jepet në shfrytëzim në afat prej 15 viteve, ju ftoj që anëtarët e KPF-së t'a kalojnë në kuvend, më pas anëtarët e kuvendit të vendosin që a do të kaloj kjo pikë apo jo.

**Burim Krasniqi** – Mirë që po prezantohet këtu, besoj që fotografitë janë prej gjeoportalit. Në seancat e radhës po rekomandj që kur kemi prona për dhënien në shfrytëzim t'a kemi edhe një analizë – gjendje të saj, a ka investuar dikush më herët? Jo për paragjykim, por është tjetër gjë kur një herë është punuar dhe tjetër gjë kur merret prona nga fillimi. Asambleja komunale në momentin që e voton e shtyen tutje një proces të caktuar, këtë po e them për hirë të informimit të plotë të asambleistëve në seancën e rregullt të asamblesë komunale, pa asnje paragjykim tjetër.

**Berat Duraku** – Faleminderit Burim, kjo është një parcelë e cila gjendet në rrugën te mulliri “Vetonii” në pjesën e quajtur Përzhinë, deri tash kjo parcelë është shfrytëzuar ose më mirë të themi ka qenë usurpim dhe në këtë fazë ne jemi duke u munduar për legalizim dhe t’ia japim dikujt në shfrytëzim i cili do të paguaj qira për komunën e Rahovcit.

**Burim Krasniqi** - Nuk fola vetëm për këtë parcelë, po flasë në përgjithësi, sepse këtu shkrua dhënia në shfrytëzim të parcelës, duhet të jemi në dijeni a ka ndonjë objekt apo jo, t'a kemi një pamje më të mire në të ardhmen, prej gjeoportalit ose googleearth një gjendje aktuale të parcelës që jepet në shfrytëzim.

**Berat Duraku** - Pa dashtë të replikoj, kjo parcelë nuk ka asnje objekt dhe me faktin që në kadastërt e kemi me dokumentacion të pastërt e kemi para kuvendarëve që t'a japim në shfrytëzim dhe në momentin që e japim në shfrytëzim normalisht se vlera e saj rritet si dhe parcelave tjera që janë afër. Në këtë zonë ka filluar ndërtimi i disa objekteve që shfrytëzohen për blektori dhe pikërisht ndoshta edhe kjo parcelë në të ardhmen do të shfrytëzohet për blektori.

**Kryesuesi** - Faleminderit drejtor dhe Burim. Dikush tjetër ndonjë gjë?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim, kush është për?... Me shumicë votash aprovohet edhe pika e pestë e rendit të ditës, kalojmë në pikën e gjashtë;

**6. Shqyrtimi propozim vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale P- 71510057-05864-0 zona, në kadastrale Rahovec;**

Komisioni formohet nga kuvendi komunal, komisioni që formohet është për pikën paraprake që e patëm në shfrytëzim të asaj prone.

**Burim Krasniqi** – Meqenëse sot është KPF-ja dhe ky si propozim-vendim kalon, kur vjen në asamble komunale, të jetë me propozime direkte nga ekzekutivi se kush është në komision, që kur t'a voton asambleja komunale t'i votoj pesë emrat. Ka kohë një javë apo 10 ditë për emra, tek e fundit në momentin që e ngris dorën dua t'a dij se kush janë ata pesë emra, që kur të vjen propozim vendimi, ekzekutivi të vie me emra, 2 emrat prej ekzekutivit, 1 prej OJQ, 2 të tjerë prej asamblesë komunale dhe e votojmë komisionin prej 5 anëtarëve. Nuk dua të paragjykoj asnje emër, thjesht të jemi në dijeni se kënd po e votojmë si asamble komunale.

**Kryesuesi** – Atëherë besoj që kjo kërkesë do të pranohet nga ekzekutivi, si të tillë po e vendosim në votim, kush është për?... Me shumicë votash aprovohet edhe pika e gjashtë e rendit të ditës, kalojmë te pika e shtatë;

**7. Shqyrtimi i propozim vendimit për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim personave fizik dhe juridik P- 71510021-00010-1 dhe P-71510021-00010-2, në zona kadastrale Dobidol;**

**Berat Duraku** – Para jush e keni materialin për tokat bujqësore të cilat komuna e Rahovecit do t'i jep në shfrytëzim, parcela me nr. 000101 zona kadastrale Dobidol, në vendin e quajtur Sorosh në sipërfaqe prej 8916m katror ose 89 ari e 16m, kulturë kullosë – arë e klasës së dytë. Kjo parcelë në planin zhvillimor komunal është e regjistruar si tokë bujqësore, qëllimi është ruajtja e pronës dhe rritja e vlerës së saj, propozimi është që këto parcela të jepen në afat prej 15 viteve, andaj ju ftoj që të kalon në kuvend dhe anëtarët e kuvendit të marrin vendim.

**Burim Krasniqi** – Më falni, ndoshta edhe po bëhem i tepërt. Prej fotos që po e shoh, kjo e hijezuara është parcela që do të jepet në shfrytëzim?... Edhe brenda edhe jasht! E dyta; kur merret si vendim, a mund të definohet që rruga e këtyre objekteve ruhet si rrugë, që mos të kemi tutje problem me pronarët tjerë kur dikush e merr në shfrytëzim këtë pronë. Së paku në propozim vendim të definohet që nëse është rrugë funksionale, le të mbetet rrugë dhe jo t'a myllim sepse dikush e ka ndonjë shtallë ose diçka tjetër sepse po shihet nuk është investim i thjeshtë.

**Kryesuesi** – Faleminderit Burim dhe drejtor, atëherë po e vendosim në votim bashkë me propozimin që objekti që operon aty të ketë çasje në rrugë, kush është për? ... Me shumicë votash aprovohet edhe pika e 7-të e rendit të ditës.

**8. Shqyrtimi propozim vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale P- 71510021-00010-1 dhe P-71510021-00010-2, në zona kadastrale Dobidol;**

**Kryesuesi** - Është e njëjta sikur pikat paraprake, formimi i komisionit nga kuvendi komunal, këtu vlen propozimi i Burimit edhe për këtë komision që dy përfaqësues nga ekzekutivi i komunës të vijnë paraprakisht në seancën e rregullt, atëherë po e vendosim në votim, kush është për?... Me shumicë vota aprovohet pika e tetë e rendit të ditës.

**9. Shqyrtimi i propozim vendimit për shfuqizimin e vendimit 01 Nr.337/22, i datës: 29.06.2022 për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës;**

**10. Shqyrtimi i propozim vendimit për shfuqizimin e vendimit 01 Nr.339/22, i datës: 29.06.2022 për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënes në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale.**

**Kryesuesi** – E lusë drejtorin Erhan morina që ta prezanton pikën e 9 dhe pikën e 10-të.

**Erhan Morina** – I nderuar kryesues, nënkyetar, të nderuar anëtarë të KPF-së, drejtorë kolegë. Para jush keni materialin për shfuqizimin e vendimit me nr.337/22 të datës 29.06.2022 për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës të paluajtshme të komunës, më konkretisht depotot e matreksit në Xërxe. Arsyja e kërkesës për shfuqizimin e këtij vendimi është sepse dy nga katër parcelat e këtij vendimi nuk kanë qenë në listën e pronave që komuna i prezanton cdo vit për dhënien në shfrytëzim dhe se MAPL për të njëjtat parcela nuk ka dhënë ligjshmérinë, vetëm dy parcela kanë patur ligjshmëri dhe ne si drejtori e kemi parë të arsyeshme që këtë vendim t'a shfuqizojmë me qëllim diku në janar – shkurt 2023 t'i fusim prapë në kuvend si pikë të rendit të ditës dhe si të tilla t'i japim të gjitha në shfrytëzim. Në vendim i kemi patur 4 parcela, MAPL ligjshmëri ka kthyer vetëm për dy parcela, si drejtori kemi parë të arseyshme që nuk ka kuptim që vetëm dy parcela të jepen në shfrytëzim për faktin që komplet depon që ne kemi dashur t'a japim në shfrytëzim nuk ka marr aprovin nga MAPL. Kemi vendosur për shfuqizim të vendimit komplet, ju ftoj që të votoni këtë pikë të rendit të ditës. Për faktin që ne e shfuqizojmë këtë vendim, duhet t'a shfuqizojmë edhe komisionin që ne e kemi krijuar për vlerësimin e këtyre ofertave, që ishte si pikë shtesë, prandaj kërkoj nga ju që të votoni edhe pikën e 10. **Burim Krasniqi** – Nuk kam diçka rrëth vendimeve të diskutoj. Drejtor, objektet që janë në shfrytëzim, në momentin që është dhënë para disa viteve, ata kanë aplikuar me një plan investiv dhe strategjik biznesor. Meqenëse ky vendim do të vie për votim, a duhet komuna të krijoj një komision për vlerësimin e zbatimit e atyre investimeve dhe t'a shohin që shfrytëzuesit a mund të janë konkurrent në garë në të ardhmen apo jo. Po rekomandoj që ta bëni një komision të brendshëm prej ekzekutivit dhe të

dilni të shihni se sa janë realizuar ato plane investive, premtimet për punësim, zhvillim të zonës dhe nëse është arritu kjo besoj që komisioni i ka në konsideratë implementimin e zotimeve, në çoftëse nuk e kan realizuar është keq me thënë por dalin në pjesën e listës së **zezë** dhe nuk mundesh me qenë konkurrent pa dashtë t'i paragjykoj asnjërin prej atyre që operojnë në ish matreksin.

**Kryesuesi – Faleminderit Burim,** si të tilla po i vendosim të dyja këto pika në votim, për shfuqizimin e këtyre dy vendimeve, kush është për?... Me shumicë votash shfuqizohen dy vendimet dhe dy pikat e rendit të ditës, kalojmë te pika e fundit;

#### 11. Të ndryshme;

**Burim Krasniqi –** Kam pritur që sot do të kemi rend dite shtesë, për shkak të vonesave qarkoret buxhetore dhe planet e diskutimeve publike që do t'i bëjë KPF-ja me qytetarë përrreth buxhetit. Kërkoj që me stafin e kuvendit të bëhet një plan të diskutimeve publike, të dërgohet në email te anëtarët e KPF-së, të marrim një pajtueshmëri që t'a dijmë se kur organizohen dëgjimet publike për buxhetin për vitin 2023 prej asamblesë prej KPF-së. E di që në shtator, por ne duhet të dakordohemi pak në mesvete si plan, sepse është fakt që është muaji shtator, por datat duhet t'i caktoj KPF-ja. Ju rekomandoj që të dakordohemi në email me cilat data shkojmë dhe me çfarë formati të dëgjimeve dhe të shkojmë tutje.

**Kryesuesi – Faleminderit Burim** për këto rekomandime, besoj që në shtator dë të jemi të gatshëm për përfundimin e këtyre dëgjimeve buxhetore. Ndonjë çështje dikush tjetër? ... Nëse jo, atëherë po e përmbyllim këtu mbledhjen e shtatë të rrregullt të KPF-së, shihemi në seancën e rrregullt.

Mbledhja përfundoj në 10:35

  
Procesmbajtësi,  
Agim Heti

